



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 9, Datë 08.04.2014


PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE “TRESKA 1”, “TRESKA 2”, “TRESKA 3” DHE “TRESKA 4” NË
LUMIN E TRESKËS, KOMUNAT VITHKUQ DHE KOLONJË, QARKU KORÇË

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e hidrocentraleve “Treska 1”, “Treska 2”, “Treska 3” dhe “Treska 4” në lumin e Treskës, në Komunat Vithkuq dhe Kolonjë, Qarku Korçë, me kërkues shoqërinë koncesionare “HEC Treska” Sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
 - a) Dokumenti i Rregullores së Lejes Zhvillimore Komplekse,
 - b) Harta e Planvendosjes së Strukturave.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet subjektit kërkues pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMEZI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



Z. DAMIAN GJKNURI

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIE



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT